

DEKLARATA E PARIMEVE TË INVESTIMEVE

HISTORIKU I VERSIONEVE

Version	Në fuqi	Ndryshimet
2.0	01.04.2024	Rishkrim nga versionet 1.0-1.9 (përdorur gjatë 2014-2023)
2.1	07.03.2025	8.5 - Kufijtë e alokimit të mjeteve; 10.4 - Pika (a) ndryshohet; Pika (d) shtohet;

© Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) 2024. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky informacion nuk përbën këshilla financiare, investuese ose profesionale dhe nuk duhet mbështetur në to. Nuk lejohet asnjë formë riprodhimi, i të gjithë apo i ndonjë pjese, të këtij materiali. FKPK-ja nuk jep asnjë zotim apo nuk jep asnjë përfaqësim apo garanci se ky material është i plotë apo pa gabime. FKPK-ja nuk pranon përgjegjësi për asnjë humbje të shkaktuar si rezultat i ndonjë gabimi, paplotësie apo pasaktësie. Logoja e FKPK-së dhe emrat tregtarë të përdorur në këtë dokument janë në pronësi të FKPK-së dhe nuk duhet të përdoren në asnjë mënyrë pa lejen tonë.

PËRMBAJTJA

1. PREZANTIMI	3
2. QEVERISJA	3
3. KOMISIONI I INVESTIMEVE.....	4
4. UNIVERSI I INVESTIMEVE	4
5. ZGJEDHJA E ASET-MENAXHERËVE DHE E FONDEVE TË PËRBASHKËTA.....	4
6. PARIMET DHE BINDJET INVESTUESE	6
7. OBJEKTIVAT E INVESTIMEVE.....	7
8. POLITIKA E INVESTIMEVE	8
9. RREZIQET.....	9
10. ZBATIMI	10
11. DOKUMENTI I STRATEGJISË SË ALOKIMIT TË MJETEVE	11
SHTOJCA 1 – KLASIFIKIMET E PËRDORURA NË POLITIKËN E INVESTIMEVE.....	12
SHTOJCA 2 – RREZIQET KRYESORE	14
SHTOJCA 3 – DOKUMENTI I ZBATIMIT TË INVESTIMEVE.....	16

TERMAT E PËRDORUR

Termi	Përkufizimi
Bordi / Bordi Drejtues	Bordi Drejtues i FKPK-së
Bordi Menaxherial	Trup i përbërë nga: Drejtori Menaxhues; DFI; DIR; dhe Drejtori për Operacione
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
DFI	Drejtor për Financa dhe TI
DI	Departamenti i Investimeve nën mbikëqyrjen e DIR
DIR	Drejtori për Investime dhe Raportim
DPI	Deklarata e Parimeve të Investimeve
DRP	Departamenti për Raportim dhe Përputhshmëri nën mbikëqyrjen e DIR
FD	Departamenti i Financave
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
KI	Komisioni i Investimeve i Bordit Drejtues
Mjetet	Mjetet pensionale nën menaxhimin e FKPK-së
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
SAA	Strategjia e Alokimit të Mjeteve

1. PREZANTIMI

- 1.1. Kjo *Deklaratë e Parimeve të Investimeve* (DPI) është përpiluar nga Bordi Drejtues i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), i cili përcakton se si investohen mjetet pensionale nën menaxhimin e FKPK-së (në tekstin e mëtejshëm “Mjetet”).
- 1.2. DPI është përgatitur në përputhje me të gjitha udhëzimet përkatëse legjislative dhe praktikat më të mira të Kosovës, dhe në veçanti në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligji Nr. 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116 (në tekstin e mëtejshëm “Ligji”), si dhe rregullat dhe rregulloret përkatëse të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).
- 1.3. DPI përcakton një sërë parimesh dhe politikash udhëzuese për të ofruar një kornizë pune objektive, efektive dhe transparente për një proces të qëndrueshëm në vendimmarrje për investimin e Mjeteve.
- 1.4. DPI do të rishikohet çdo vit nga Bordi Drejtues, nëpërmjet Komisionit të Investimeve të FKPK-së (në tekstin e mëtejshëm “KI”), dhe pa vonesë nëse do të ndodhë ndonjë ndryshim i rëndësishëm në qasjen e investimit, objektivat, kufizimet, tolerancën ndaj rrezikut, horizontin e investimeve, ose grup-moshat e pjesëmarrësve.

2. QEVERISJA

- 2.1. Përmes Ligjit, FKPK-së i është dhënë kompetenca ekskluzive për t’i investuar Mjetet.
- 2.2. Detyra kryesore e Bordit Drejtues është të sigurojë që Mjetet të investohen në mënyrë të kujdesshme në përputhje me kërkesat e ligjit, vetëm për përfitimin e pjesëmarrësve dhe përfituesve të tyre.
- 2.3. Bordi Drejtues pranon se ka përgjegjësi fiduciare ndaj pjesëmarrësve dhe përfituesve në FKPK dhe do të ndjekë vetëm politika të cilat nuk e shkelin këtë përgjegjësi.
- 2.4. Përderisa Bordi Drejtues është përfundimisht përgjegjës për qeverisjen dhe investimin e Mjeteve, ai mund t’i delegojë disa detyra kompanive aset-menaxhuese ose komisioneve apo organeve përkatëse brenda FKPK-së. Kur vepron kështu, Bordi Drejtues duhet të sigurohet se, komisionet dhe organet e tij, si dhe menaxherët në kompanitë aset-menaxhuese të përzgjedhura, kanë ekspertizë dhe burime të mjaftueshme për t’i kryer rolet e tyre në mënyrë efektive.
- 2.5. Bordi Drejtues ose organet tjera përkatëse brenda FKPK-së, mund të angazhojnë konsulentë për investime dhe/ose kompani për të ofruar këshilla dhe shërbime për investime, siç përcaktohet në marrëveshjen ndërmjet FKPK-së dhe palëve të tilla.

3. KOMISIONI I INVESTIMEVE

- 3.1. Bordi Drejtues ka themeluar një Komision Investimesh, përgjegjësia kryesore e të cilit është të mbështesë Bordin Drejtues me vendimet që kanë të bëjnë me investimin e Mjeteve, duke ofruar mbikëqyrje të funksionit të investimeve.
- 3.2. Anëtarët e KI-së emërohen në përputhje me Statutin e FKPK-së dhe duhet të kenë aftësi, ekspertizë, bagazh profesional dhe përvojë të mjaftueshme për të kryer rolin e tyre në mënyrë efektive.
- 3.3. KI do të monitorojë dhe rishikojë vazhdimisht, në bazë të informacionit të disponueshëm: performancën, rreziqet, likuiditetin, diversifikimin dhe përshtatshmërinë e investimeve. Këto do të raportohen zyrtarisht në mbledhjet e rregullta të Bordit Drejtues.
- 3.4. KI do ta shqyrtojë këtë DPI të paktën një herë në vit dhe do t'ia propozojë ndryshimet Bordit Drejtues.
- 3.5. KI do të monitorojë pajtueshmërinë me këtë DPI në baza tremujore.

4. UNIVERSI I INVESTIMEVE

- 4.1. Mjetet investohen në lloje të ndryshme të klasave të aseteve, si aksionet, obligacionet, mallrat dhe tregu i parasë. Investimet realizohen direkt ose përmes një sërë strukturash ligjore dhe fonde investimesh (p.sh. fondet e përbashkëta dhe të tregtueshme) që konsiderohen të përshtatshme për FKPK-në si fond pensional dhe investitor afatgjatë.
- 4.2. Investimet direkte duhet të bëhen kryesisht në letrat me vlerë që tregtohen publikisht në tregjet e rregulluara. Investimet në: (a) letra me vlerë që nuk tregtohen publikisht në tregjet e rregulluara; dhe (b) obligacione me rangim jo-investues; duhet mbajtur në një nivel të ulët. E njëjta gjë do të vlejë për letrat specifike me vlerë brenda fondeve investuese.
- 4.3. Derivativët, nëse ka, mund të përdoren vetëm për mbrojtje kundër rreziqeve dhe duhet të ndërmerren në mënyrë të kujdesshme dhe me kosto efektive, duke marrë parasysh ekspozimet e mundshme ndaj një pale të vetme ose derivativëve të tjerë.
- 4.4. Mjetet duhet të diversifikohen në mënyrë të mjaftueshme dhe efektive në mënyrë që të mos varen ekskluzivisht nga ndonjë klasë e caktuar e aseteve, emetues ose fond investues.
- 4.5. Universi i investimeve dhe kufizimet për secilin portofol janë dhënë në Politikën e Investimeve të përfshira në këtë DPI.
- 4.6. Një pasqyrë e alokimit aktual të mjeteve publikohet çdo ditë në faqen e internetit të FKPK-së për secilin portofol.

5. ZGJEDHJA E ASET-MENAXHERËVE DHE E FONDEVE TË PËRBASHKËTA

- 5.1. Emërimi i aset-menaxherëve dhe e fondeve të përbashkëta është përgjegjësi e KI-së, përmes një procesi konkurrues të përzgjedhjes në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare të ndjekura nga një proces rigoroz i kujdesit të duhur.

- 5.2. KI mbështetet në këto procese nga Bordi Menaxherial, përgjegjës për përcaktimin e kritereve të përzgjedhjes në përputhje me aktet e brendshme dhe rekomandim në KI nga lista e ngushtë e ofertuesve. KI, me miratimin e Bordit Drejtues, mund të sigurojë gjithashtu këshilla të jashtme për të ndihmuar në këtë proces.
- 5.3. KI ka zgjedhur të mos i investojë Mjetet përmes mandatit të ndarë me ndonjë aset-menaxher; dhe në vend të kësaj ka vendosur ta përmbush përgjegjësinë e vet për investime të matura të Mjeteve duke investuar në fonde të përbashkëta dhe fonde të tregtueshme në bursa, të cilat ofrojnë diversifikim dhe investime drejtimore me kosto më të ulët.
- 5.4. KI investon në fonde të ndryshme por nuk mbështetet në asnjë fond të vetëm që të përmbushen objektivat investuese të FKPK-së në tërësi. Fondet e përbashkëta përbëhen nga një apo më shumë klasa të aseteve dhe duhet t'i plotësojnë kriteret e investimeve të FKPK-së për sa i përket historikut, madhësisë së aseteve, universit e strategjisë së investimeve, dhe diversifikimit.
- 5.5. Kompanitë menaxhuese të fondeve të përbashkëta duhet të përmbushin dhe ruajnë shkallën më të lartë të integritetit, etikës dhe standardeve profesionale. Ato janë të autorizuar dhe të rregulluara nga autoritetet përkatëse për mbikëqyrje financiare të Republikës së Kosovës ose OBZHE.
- 5.6. Menaxhimi i përditshëm i mjeteve të investuara përmes fondeve të përbashkëta kryhet nga kompanitë menaxhuese përkatëse, të cilat i ofrojnë raporte të rregullta FKPK-së.
- 5.7. KI do të monitorojë rregullisht performancën e investimeve të fondeve të përbashkëta dhe do të vlerësojë nëse ato janë në përputhje me objektivat për të cilat janë përzgjedhur. KI dhe anëtarët e Bordit Menaxherial mund të zhvillojnë takime periodike me menaxherët e fondeve të përbashkëta aktive për t'i diskutuar performancën dhe pritshmëritë.

6. PARIMET DHE BINDJET INVESTUESE

- 6.1. FKPK do të marrë vendime për investime duke vepruar vetëm në interesin më të mirë të pjesëmarrësve, duke iu përmbajtur prioriteteve të mëposhtme:
- Siguria e Mjeteve;
 - Diversifikimi i investimeve;
 - Kthimi maksimal nga investimet në përputhje me sigurinë e Mjeteve; dhe
 - Mirëmbajtja e likuiditetit të mjaftueshëm.
- 6.2. Bordi Drejtues do të përpiqet të sigurojë që FKPK të ketë:
- Procese efektive dhe efikase të investimeve;
 - Nivel të duhur të ekspertizës për analiza dhe veprimtarinë e investimeve në përgjithësi; dhe
 - Një qasje rigorozë për menaxhimin e shpenzimeve për investime dhe operacione.
- 6.3. Bordi drejtues do të marrë gjithashtu parasysh se:
- FKPK është investitor afatgjatë ;
 - Ekziston nevoja për të diversifikuar në mënyrë efektive midis klasave të ndryshme të asetëve dhe brenda vetë një klase të caktuar të asetëve;
 - Megjithëse performanca investuese matet - dhe tërheqja e kursimeve i paguhet pjesëmarrësve - në euro, kjo nuk duhet ta kufizojë investimin vetëm në Euro asetë; dhe
 - Pjesëmarrësit duhet ta ruajnë besimin e tyre në institucionin e FKPK-së, për çfarë arsye edhe nevojitet një politikë e kujdesshme investuese.
- 6.4. Bordi Drejtues ka përvetësuar një sërë bindjesh investuese për të ofruar një kornizë objektive dhe transparente për vendimmarrje të qëndrueshme të investimeve. Këto bindje veprojnë si udhëzues për mundësim të kryerjes efektive të të gjitha funksioneve të investimit.
- 6.5. Bindjet e Bordit Drejtues janë:
- FKPK-ja do të duhet të ndërmarrë rrezik investues për të përmbushur objektivat investuese.
 - Klasa të ndryshme asetesh kanë karakteristika të ndryshme, varësisht tregjeve dhe cikleve të ndryshme ekonomike. Megjithatë, investitorët afatgjatë dhe të durueshëm, fitojnë kthime më të mira duke investuar në asetë që pritet të kenë kthim dhe risk më të lartë, veçanërisht në aksione. FKPK është pozicionuar mirë për të përfituar nga kjo, duke pasur parasysh profilin e moshës së pjesëmarrësve.
 - Performanca afatgjatë është shumë më e rëndësishme sesa lëvizjet afatshkurtra; duke qenë se rëniet në tregjet financiare (zakonisht) jo vetëm që rikuperohen me kalimin e kohës, por gjithashtu ofrojnë mundësi investuese.
 - Alokimi i mjeteve është faktor përcaktues në performancën afatgjatë.
 - Diversifikimi është mjet i rëndësishëm për menaxhimin e riskut dhe kthimit.
 - Fondet pasive të indeksuara në përgjithësi ofrojnë qasje në një klasë asetesh me kosto më të ulët, shpesh me performancë më të mirë në afat të gjatë.
 - Menaxhimi aktiv ofron qasje të ndryshme investimi ndaj një klase të caktuar asetesh, duke zgjeruar shkallën e diversifikimit në atë klasë asetesh.
 - Fondet aktive, qofshin të përbëra nga një ose më shumë klasa asetesh, përmes përzgjedhjes dinamike, pozicionimit në treg dhe/ose menaxhimit të riskut, mund të arrijnë kthime të qëndrueshme me më pak luhatshmëri.
 - Një funksion i brendshëm investues, me ekspertizë, i mirë-qeverisur dhe me burime adekuate mund të ndihmojë në arritjen e rezultateve më të mira afatgjata.

7. OBJEKTIVAT E INVESTIMEVE

- 7.1. Bordi Drejtues ka përcaktuar se, për të vepruar në interesin më të mirë të pjesëmarrësve, niveli i riskut investues duhet të përshtatet për pjesëmarrësit në bazë të moshës së tyre, gjë që kërkon aplikimin e strategjive të ndryshme investuese për grup-mosha të ndryshme deri në moshën 65 vjeçare të daljes në pension.
- 7.2. Në përputhje me detyrën e tij fiduciare dhe nevojën për maturi, Bordi Drejtues do të kërkojë të gjenerojë kthimin më të lartë të mundshëm në përputhje me nivelin e pranueshëm të riskut për çdo grup.
- 7.3. Për këtë qëllim, Bordi Drejtues ka ndarë menaxhimin e Mjeteve në tri strategjitë investuese ("Portfolio") në vijim:
- (a) Portfolio Standarde;
 - (b) Portfolio e Ndërmjetme; dhe
 - (c) Portfolio Konservative.
- 7.4. Portfoliot do të kenë përbërjen dhe profilet e mëposhtme:

	Standard	Ndërmjetme	Konservative
Grup-mosha	15-57	58-62	63+
Objektivi i investimit¹	Rritje më e lartë e mjeteve, që tejkalon me +3% inflacionin mesatar 10-vjeçar në Kosovë	Rritje mesatare/e lartë e mjeteve, që tejkalon me +2% inflacionin mesatar 10-vjeçar në Kosovë	Siguri dhe stabilitet i mjeteve, baraz ose mbi normën mesatare të obligacioneve kosovare për 2 vitet e fundit
Qasja e investimeve	Me kahje drejt asetëve afatgjata me pritshmëri për kthim më të lartë, për ofrim të potencialit më të madh për rritje	Alokim më i balancuar midis asetëve afatgjata dhe atyre me risk të ulët, për tranzicion të pjesëmarrësit nga faza e rritjes në atë para-pensionale	Me kahje drejt asetëve me risk më të ulët dhe kthim të pritur të ulët / mesatar, për të ulur efektet e luhatjeve të mëdha e afatshkurtra në tregje
Toleranca për risk	Moderuar – E lartë	E moderuar	E ulët
Likuiditeti	Nevojë e ulët për likuiditet që mund të plotësohet lehtësisht nga kontributet hyrëse dhe/ose instrumentet ditore të tregtueshme	Nevojë e ulët për likuiditet që mund të plotësohet lehtësisht nga kontributet hyrëse, transfertat në portfolio ose instrumentet ditore të tregtueshme	Nevojë e moderuar për likuiditet që do të duhej plotësuar lehtësisht nga transfertat në portfolio dhe mbajtja e nivelit të përshtatshëm të parasë së gatshme

1) Bordi rezervon të drejtën të vendosë pika referente shtesë për performancën, riskun dhe likuiditetin e investimeve.

- 7.5. Matësi i inflacionit i caktuar nga Bordi Drejtues është Indeksi vjetor i Çmimeve të Konsumit i Kosovës, i publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës. Vënia e inflacionit si objektivi është kyç për mbajtjen e fokusit jo vetëm në mbrojtjen por edhe në rritjen e vlerës reale të asetëve.

8. POLITIKA E INVESTIMEVE

- 8.1. Bordi Drejtues ka vendosur se aplikimi i portfoliove sipas grupmohave heq nevojën për të balancuar plotësisht interesat e pjesëmarrësve që janë afër pensionit dhe atyre që kanë shumë vite përpara tërheqjes së kursimeve të tyre pensionale.
- 8.2. Portfolio Standard, me objektiv për rritje dhe tolerancë ndaj riskut më të lartë, kërkon alokim më të madh në asete me pritshmëri për kthim dhe risk më të lartë në periudha afatgjata, siç janë aksionet. Për të ulur riskun, këto investime duhet të plotësohen me alokime në instrumente që diversifikojnë riskun e portfolios, veçanërisht ato me risk historik më të ulët dhe/ose me kthime të pritshme më të qëndrueshme.
- 8.3. Portfolio e Ndërmjetme, me objektiv për rritje të moderuar / të lartë dhe tolerancë të moderuar ndaj riskut, kërkon një përqindje të arsyeshme por jo të tepruar të alokimit në asete afatgjata me kthim dhe risk të lartë, të tilla si aksionet, të balancuara me një alokim relativisht më të lartë sesa tek Portfolio Standard në instrumente me risk historik më të ulët dhe/ose me kthime të pritshme më të qëndrueshme.
- 8.4. Portfolio Konservative, me objektiv për siguri dhe stabilitet të mjeteve dhe tolerancë të ulët ndaj riskut, kërkon shumicë dërrmuese alokimesh në instrumente që ofrojnë risk më të ulët dhe kthime të pritshme më të qëndrueshme. Për më tepër, vetëm instrumentet në Euro do të përdoren për të shmangur efektet negative të riskut të këmbimit valutor.
- 8.5. Bordi Drejtues është përgjegjës për rishikimin dhe vendosjen e kufijve për alokimin e mjeteve me rekomandimin e KI. Kufijtë e alokimit të mjeteve për portfoliot janë:

Klasifikimi	Standard	Ndërmjetme	Konservative
Rritje	50-80	40-65%	0-10%
Aksione – Pasive	40-60%	25-40%	-
Aksione - Aktive	10-40%	15-25%	0-10%
Aksione - Tematike / Individuale	0-15%	0-12%	-
Asete Reale - Rritje	0-10%	0-8%	-
Obligacione - Rang i ulët	0-5%	0-4%	-
Stabilitet	0-50%	20-60%	50-99%
Obligacione – Thesari i Kosovës	0-25%	20-60%	50-99%
Obligacione – Rangimi Investues	0-25%	0-25%	0-30%
Multi-Asete	0-15%	0-25%	0-10%
Asete Reale - Stabilizuese	0-15%	0-15%	-
Depozita me afat	0-10%	0-20%	0-20%
Taktik	0-20%	0-10%	0-10%
Të gjitha klasat e asetëve	0-20%	0-10%	0-10%
Likuiditet	0-10%	0-40%	1-30%
Tregje të parasë	0-10%	0-40%	0-29%
Llogari rrjedhëse	0-1%	0-1%	1-10%

Shënim: Shtojca 1 ofron përshkrim të klasifikimeve të sipërpërmendura

8. POLITIKA E INVESTIMEVE (VAZHDIM)

- 8.6. Bordi Drejtues beson se përcaktimi sipër i kufijve minimalë dhe maksimalë ofron:
- (a) përqendrim në objektivin afatgjatë të investimeve duke qenë i vetëdijshëm për rreziqet e ndërlidhura;
 - (b) kornizë për diversifikim të balancuar dhe një kombinim i caqeve përgjatë kohës;
 - (c) mbështetje për analiza dhe ndryshime taktike të bazuara në hulumtim;
 - (d) disiplinë ribalancuese dhe plasman i arsyeshëm i parasë së gatshme.
- 8.7. Çdo shkelje për shkak të mbi apo nën performancës nga ndonjë kategori asetesh dhe/ose instrumente do të korrigjohet brenda tre muajve nga identifikimi. Në rast të çrregullimeve në tregje, këta kufij mund të pezullohen përkohësisht me një vendim të Bordit Drejtues.
- 8.8. Bordi Drejtues është i vetëdijshëm për rreziqet e pashmangshme nga ndjekja e një politike që mbipeshon aksionet në portfoliot Standard dhe të Ndërmjetme, por beson se, në afatgjatë, aksionet pritet të gjenerojnë kthim total më të lartë sesa asetet tjera. Prandaj, aksionet janë thelbësore për arritjen e objektivave afatgjata të këtyre portfoliove. Pavarësisht nëse ato janë afatgjata apo taktike, investimet duhet të kombinojnë qasje pasive dhe aktive sipas nevojës, në një sërë rajonesh, sektorësh, faktorësh dhe strategjish investuese. Vendimet duhet të mbështeten nga analiza adekuate.
- 8.9. Përgjatë kushteve normale në tregje, kursimet e pjesëmarrësve do të transferohen nga portfolio Standard në atë të Ndërmjetme dhe nga portfolio e Ndërmjetme në atë Konservative, në muajin gjatë të cilit pjesëmarrësit mbushin ditëlindjen e 58-të, përkatësisht të 63-të. Megjithatë, në rastet e rënieve të ndjeshme të performancës¹, bartjet mund të pezullohen nga Bordi Drejtues derisa të mbizotërojnë kushte më të favorshme në tregje.
- 8.10. Bordi Drejtues është i përkushtuar se rregullisht do të rishikojë politikën e investimeve të secilës portfolio, dhe nevojën për portfolio shtesë, për t'iu përshtatur kohëzgjatjes dhe profilit të riskut të një grupmoshe të caktuar. Bordi Drejtues po ashtu është i përkushtuar që rregullisht të shqyrtojë mundësinë dhe përshtatshmërinë për investime të reja në Kosovë.

9. RREZIQET

- 9.1. Bordi Drejtues i konsideron rreziqet e investimeve nga këndvështrime të ndryshme. Këto rreziqe merren parasysh kur ndërtohen dhe rishikohen procedurat e përgjithshme të investimeve në kuadër të një kornize të përshtatshme për trajtim dhe/ose adresim të tyre.
- 9.2. KI, në baza të rregullta, do të vlerësojë ekspozimin direkt dhe indirekt ndaj rreziqeve investuese dhe do të vlerësojë nëse ato janë në përputhje me politikën investuese. KI do t'i rekomandojë Bordit Drejtues masa ose zgjidhje për trajtim të riskut, propozime për ndryshime në kufijtë ose caqet ekzistuese të riskut, ose vetë procesin e menaxhimit të riskut.
- 9.3. Shtojca 2 ofron një listë të rreziqeve kyçe për Mjetet dhe qasjet e ndërmarra për trajtimin e tyre.

¹ Rënie mbi 5% për Portfolion Standard dhe mbi 3% për Portfolion e Ndërmjetme nga piku i çmimeve përkatëse të njësisë.

10. ZBATIMI

- 10.1. Të gjitha vendimet e politikave, caqet e alokimit dhe limitet e ekspozimit janë përgjegjësi ekskluzive e Bordit Drejtues, pas rekomandimeve të KI-së, ndërsa zbatimi i delegohet Bordit Menaxherial.
- 10.2. KI, bazuar në rekomandimet proaktive të Bordit Menaxherial, në përputhje me këtë DPI dhe SAA:
- (a) Vendos për emërimin dhe largimin e aset-menaxherëve, mbajtësve, ndërmjetësve, dhe fondeve të përbashkëta;
 - (b) Vendos për të rritur apo reduktuar pozicionin në një fond të aprovuar të përbashkët apo të tregtueshëm në bursa;
 - (c) Vendos të blejë ose shesë letra me vlerë individuale të tregtueshme publikisht ose fonde të tregtueshme në bursa;
- Bordi duhet të informohet nga koordinatori i KI brenda 24 orëve nga marrja e vendimeve.
- 10.3. Bordi Drejtues është i vetëdijshëm se, kur fondet e përbashkëta ose të tregtueshme në bursa përzgjidhen për investim të Mjeteve, menaxherët e fondeve përkatëse kanë diskrecion për të blerë dhe shitur letrat përbërëse me vlerë. Megjithatë, KI-së bazuar në analizën e Bordit Menaxherial, obligohet që vazhdimisht të rishikojë nëse mandati, metodologjia dhe ekspozimet e fondeve përkatëse janë në përputhje me objektivat e FKPK-së.
- 10.4. Bordi Menaxherial, në përputhje me këtë DPI dhe SAA, i delegohet kompetenca:
- (a) të ndërmerr ftesë për oferta, dhe caktojë shumat, për afatizime me bankat tregtare të licencuara nga BQK;
 - (b) të hyjë në REPO aranzhime me bankat tregtare të licencuara nga BQK;
 - (c) vendos për normën dhe shumën ofertuese për obligacionet e Thesarit të Kosovës në ankandet primare, si dhe transaksionet në tregun sekondar; dhe
 - (d) vendos për plasmanin e tepricës së akumuluar të parave të gatshme në fondet e tregut të parasë, sipas nevojës.
- KI duhet të informohet brenda 24 orëve nga marrja e vendimeve.
- 10.5. Pavarësisht nëse vendimi merret nga KI sipas pikës 10.2 ose nga Bordi Menaxherial sipas pikës 10.4 sipër, në të gjitha rastet vendimi duhet të mbështetet nga një arsyetim, analizë dhe hulumtim, si dhe ex-post ndikimin në risk, para se zbatimi të fillojë.
- 10.6. Menaxhimi i parasë për qëllime likuiditeti i delegohet Bordit Menaxherial.
- 10.7. KI dhe/ose Bordi Menaxherial, mund të rekomandojnë iniciimin e ftesës për oferta për fonde të përbashkëta shtesë apo tërheqjen nga një fond i miratuar.
- 10.8. KI shqyrton vendimet dhe performancën e investimeve në baza tremujore dhe i raporton Bordit Drejtues nëse investimet janë në përputhje me politikën dhe me risk të pranueshëm. KI mund të udhëzojë Bordin Menaxherial që bazuar në bindjet e tyre, të përshtatë pozicionin e riskut investues.
- 10.9. Dokumenti i Zbatimit të Investimeve në Shtojcën 3 ofron një listë të detajuar të detyrave dhe përgjegjësive për procesin e investimit.

11. DOKUMENTI I STRATEGJISË SË ALOKIMIT TË MJETEVE

- 11.1. Dokumenti i Strategjisë së Alokimit të Mjeteve (SAA) ofron një përshkrim të klasave të aseteve dhe alokimet e synuara për çdo portfolio, të miratuar nga KI dhe në përputhje me këtë DPI.
- 11.2. Përveç kësaj, SAA ofron limitet e ekspozimit të pambrojtur valutor për investime direkte, të miratuara nga KI.
- 11.3. SAA do të përmbajë gjithashtu një shtojcë me informacionet e mëposhtme, mirëmbajtur nga Bordi Menaxherial:
 - (a) Pikëpamjet (makro dhe fundamentale) në të cilat ato bazohen;
 - (b) Pikëpamjet mbi sektorët e industrisë dhe klasat e aseteve;
 - (c) Për letrat me vlerë individuale dhe fondet, universin e tyre, klasat e aseteve dhe ekspozimet tjera, kushtet në të cilat pritet të kenë performancën më të mirë, dhe arsyetimin për madhësisë e alokimit në to; dhe
 - (d) Historiku i ndryshimeve në alokimet taktike dhe afatgjata.
- 11.4. KI do të shqyrtojë SAA-në sipas nevojës dhe do të monitorojë përputhjen e investimeve me SAA-në në baza tremujore.

Shtojca 1 – Klasifikimet e përdorura në Politikën e Investimeve

Përshkrimet e mëposhtme shpjegojnë se çfarë lloj investimesh dhe fondesh përfshihen në një klasifikim specifik sipas Politikës Investuese.

Rritje

Investime në instrumente me horizont afatgjatë (5-7 vjet), që zakonisht shiten për shkak të ribalancimit, realizimit të fitimit, maturimit, çrregullimeve të mëdha në tregje, ose nën-performancë të vazhdueshme. Klasat e asetëve të përfshira në strategjinë e Rritjes janë:

Klasa e asetit	Përshkrimi
Aksionet Pasive	Fondet e përbashkëta dhe të tregtueshme në bursa, ku përzgjedhja e aksioneve rrjedh nga një indeks i investueshëm (p.sh. MSCI World) dhe/ose nëngrupe brenda një universi të letrave me vlerë (p.sh. vlera e kapitalit, kategorizimi vlerë, dividendë); në vend të përzgjedhjes aktive dhe/ose qëndrimeve
Aksionet Aktive	Fondet e përbashkëta dhe në masë më të ulët fondet e tregtueshme në bursa, të cilat bëjnë një përzgjedhje aktive nga një univers i paracaktuar aksionesh dhe/ose kanë qasje aktive ndaj menaxhimit të riskut dhe/ose caqeve të riskut
Aksionet Tematike	Fondet e përbashkëta ose të tregtueshme në bursa të përbëra nga letra me vlerë të kompanive të një trendi ose tematike të caktuar (p.sh. ekonomi e argjendte, siguri kibernetike, megatrend, çrregullues) që pritet të formësojnë të ardhmen e ekonomisë globale
Aksionet Individuale	Aksionet e çdo kompanie të listuar publikisht në Kosovë ose OBZHE
Asete Reale - Rritje	Investimet afatgjata në burimet natyrore (p.sh. tokë bujqësore, pyje, minerale dhe të drejtat minerare)
Obligacionet – Rang i ulët	Plasmanet direkte në instrumentet e borxhit të rangut të ulët të tregtuar publikisht brenda Kosovës ose OBZHE; fonde të përbashkëta ose të tregtueshme në bursa të përbëra kryesisht nga letra me vlerë të borxhit me rang të ulët; të lëshuara nga thesaret, komunat ose korporatat. Zakonisht ato ofrojnë norma më të larta në krahasim me obligacionet me rangim investues

Stabilitet

Investimet në instrumente me horizont afatmesëm deri në afatgjatë (zakonisht 2-10 vjet), me pritshmëri më të ulët të riskut. Ato kryesisht shiten për shkak të maturimit, ribalancimit, realizimit të fitimit ose nënperformancës së vazhdueshme. Klasat e asetëve të përfshira në strategjinë e stabilitetit janë:

Klasa e asetit	Përshkrimi
Obligacione të Thesarit të Kosovës	Instrumentet e borxhit të emtuara nga Thesari i Republikës së Kosovës, zakonisht të mbajtura deri në maturim
Obligacione me Rangim Investues	Plasmane direkte në instrumentet e borxhit me rangim investues që tregtohen publikisht brenda Kosovës ose OBZHE; fonde të përbashkëta ose të tregtueshme në bursa të përbëra kryesisht nga letra me vlerë të borxhit me rangim investues; të lëshuara nga thesaret, komunitat ose korporatat
Multi-asete	Fondet e përbashkëta ose të tregtueshme në bursa të përbëra nga një miks i klasave të asetëve (p.sh. aksione, obligacione, mallra, treg i parasë)
Asete Reale – Fundament	Investime afatgjata në pasuri të paluajtshme dhe infrastrukturë
Depozita me afat	Depozita me afat dhe marrëveshje të riblerjes me institucionet bankare vendore dhe ndërkombëtare, zakonisht të mbajtura deri në maturim

Taktik

Investime me një horizont më të shkurtër, zakonisht jo më pak se 6 muaj dhe jo më shumë se 2 vjet, bazuar në analizat, pikëpamjet dhe pritshmëritë (për shembull mbi normat e interesit apo inflacionin), për një klasë të caktuar asetesh ose sektor të industrisë, faktorë gjeopolitikë dhe të tjerë. Përfshijnë çdo klasë asetesh dhe/ose investim të lejuar me ligj.

Likuiditet

Mjete të mbajtura në para të gatshme për qëllime likuiditeti dhe/ose për rastet e investimeve që mund të shfaqen në të ardhmen. Klasat e asetëve të përfshira në strategjinë e Likuiditetit janë:

Klasa e asetit	Përshkrimi
Tregjet e parasë	Fonde me likuiditet të lartë që përbëhen nga instrumente afatshkurtër që ofrojnë kthim të përafërt me Euribor; përdoret më shumë në kohë pasigurie dhe/ose perspektivë pesimiste për aksionet, e që zakonisht japin kthim më të lartë sesa llogaritë bankare
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	Bilancet e parasë së gatshme në llogaritë bankare me BQK-në dhe brokerët. Bilanci i parasë së gatshme mbahet në minimum me likuiditet të mjaftueshëm për t'i paguar tërheqjet e kursimeve

Shtojca 2 – Rreziqet kryesore

Risku i inflacionit

Meqenëse inflacioni gërryen fuqinë blerëse në baza reale, FKPK-ja e përdor atë si mbështetje për objektivat e vendosura të performancës. Kombinimi i klasave të asetëve brenda secilës Portfolio pritet t'i përmbushë objektivat e portfolios përkatëse për arritjen ose tejkalimin e inflacionit.

Inflacioni më i lartë zakonisht rezulton në norma më të larta të interesit, dhe një inflacion më i lartë me shumë gjasë përkthehet në risk më të lartë për pozicionet në obligacioneve me maturitet më të gjatë, dhe investimet do të duhet të përshtaten krahas rrethanave. Vlera nominale e asetëve me risk më të lartë pritet të rritet në periudha inflacioni, dhe nëse kjo qëndron, investimet në aksione po ashtu do të mund të rregulloheshin.

Risku i tregut

Asnjë portfolio investuese nuk mund të arrijë kthime pa ndërmarrë risk të tregut. Dhe, pasi të ketë investime, tërësisht ose pjesërisht, asnjë portfolio nuk mund të izolohet plotësisht nga risku dhe luhatjet e tregut. Fondet pensionale investojnë për periudha afatgjata, dhe duke mbajtur pozicione, vlera e investimeve përgjatë kohës mund të ndryshojë pozitivisht apo negativisht.

Diversifikimi do të përdoret si faktor kyç për menaxhimin e riskut të tregut. Për këtë qëllim, FKPK-ja do të përpiqet të identifikojë fonde dhe investime të tjera që kanë korrelacion të ulët me tregjet kryesore, si dhe fonde që përdorin strategji me risk të targetuar, risk të menaxhuar, apo të tilla që aplikojnë strategji të kthimit absolut.

Risku valutor

Investimet e realizuara në instrumente që nuk kanë për bazë valutën jo-Euro bartin riskun e lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit. Si një mënyrë për ta menaxhuar këtë risk, është vendosur kufiri maksimal i ekspozimit ndaj riskut (të pambrojtur) valutor prej 25% të mjeteve, ku instrumentet e tjera duhet të kenë vetëm ekspozim ndaj Euros ose që mbrohen (pjesërisht ose plotësisht) në Euro.

Risku kreditor dhe palës së kundërt

Risku i palës së kundërt është risku që pala tjetër në një transaksion investues, huazues ose tregtues mund të mos përmbushë obligimin e vet kontraktual. Më specifikisht, risku kreditor është risku i humbjes financiare që vjen nga mospërmbushja e detyrimeve të tilla kontraktuale.

Këto rreziqe menaxhohen përmes një qasje rigoroze gjatë blerjes së fondeve të përbashkëta dhe atyre të tregtueshme në bursa, si dhe rishikimit të vazhdueshëm të informacionit të disponueshëm, siç janë pozicionet e mbajtura nga fondet, auditimet e jashtme dhe raportet e tjera të fondeve, për të ndihmuar në vlerësimin e riskut.

Në lidhje me obligacionet si ato të Thesarit të Kosovës dhe depozitat bankare, në vazhdimësi bëhet një rishikim i borxhit publik dhe/ose metrikës që tregon shëndetin e bankave.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është rreziku që investimet mund të mos jenë lehtësisht të tregtueshme kur kërkohet për të përmbushur detyrimet që lidhen me obligimet financiare.

Risku i likuiditetit menaxhohet duke vlerësuar riblerjet mujore që vijnë nga tërheqja e kursimeve, si dhe refondimet, dhe duke mbajtur para të mjaftueshme për këtë qëllim. Risku i likuiditetit të FKPK-së parashikohet të jetë shumë i ulët për një kohë të gjatë, duke pasur parasysh se riblerjet mujore janë shumë më të ulëta se kontributet e arkëtuara mujore.

Risku i vlerësimit

Shumica e mjeteve të investuara përmes fondeve të përbashkëta dhe të tregtueshme në bursa, janë investuar në asete likuide dhe të listuara për të menaxhuar riskun e vlerësimit. Ekspozimet në obligacione që nuk mbahen sipas metodës së vlerës së drejtë, vlerësohen me koston amortizuese nëse mbahen deri në maturim.

Risku operacional dhe i reputacionit

FKPK shqyrton rregullisht sistemet e brendshme të kontrollit dhe ka një zyrtar të caktuar të riskut, procese rigorozë të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, për të siguruar që rreziqet operationale të minimizohen aq sa është e mundur.

Transparenca, profesionalizmi, efikasiteti, standardet e larta dhe matura janë shtyllat mbi të cilat është ndërtuar reputacioni i FKPK-së.

Risku i koncentrimt

Ky është rreziku i humbjes që vjen nga ekspozimi, direkt ose indirekt, brenda ose ndërmjet llojeve të ndryshme të rrezikut si rajoni, emetuesi, sektori, fondi investues ose klasa e aseteve. FKPK e kufizon këtë rrezik duke diversifikuar pozicionet alokuese brenda dhe përgjatë këtyre ekspozimeve.

Risku jo-financiar

Si investitor global, FKPK-ja monitoron me kujdes rreziqet jo-financiare si ato politike, gjeopolitike, tregtare dhe ekonomike gjatë investimit. Si investitor afatgjatë, FKPK synon të menaxhojë implikimet e një sërë rreziqesh, ndërkohë që synon portfolio të diversifikuara globalisht, të përmirësojë kthimin e përshtatur me risk, si dhe të shfrytëzojë mundësitë globale investuese.

Risku i transferimit

Politika e ciklit jetësor të FKPK-së parashikon që, me kalimin e moshës së pjesëmarrësve, mjetet e tyre duhet të transferohen në portfolio ku pritshmëritë e riskut janë progresivisht më të ulëta.

Kushte të pafavorshme të tregut mund të mbizotrojnë përgjatë transferimit të planifikuar, që mund të rezultojë në humbje afatshkurtra. Për të minimizuar këtë risk, Bordi Drejtues rezervon të drejtën të pezullojë transferet automatike nga një portfolio në tjetrën dhe të rifillojë transferimet kur tregjet të rimëkëmbejnë, pjesërisht ose plotësisht.

Mbrojtja

Mbrojtja, kur është me kosto efektive, mund të përdoret për të zbutur efektet negative të inflacionit, këmbimit valutor dhe rreziqeve të tjera.

Shtojca 3 – Dokumenti i Zbatimit të Investimeve

Detyra	Përgatitja	Organi rekomandues / shqyrtues	Organi vendimmarrës	Zbaton
Rishikimi vjetor i DPI	Bordi Menaxherial	KI	Bordi Drejtues	DI
Rishikimi i performancës dhe pajtueshmërisë (tremujore)	DI DRP	DIR	KI	DI DRP
Rishikimi vjetor i SAA	Bordi Menaxherial	KI	Bordi Drejtues	ID
Mbajtësit dhe brokerët:				
Inicimi dhe Tërheqja	DIR	Bordi Menaxherial	KI	
Kriteret e përzgjedhjes		DIR	Bordi Menaxherial	DI
Lista e shkurtër dhe kujdesi		DIR	Bordi Menaxherial	DI
Përzgjedhja dhe njoftimi		Bordi Menaxherial	KI	DI
Aset-menaxherët dhe fondet:				
Inicimi dhe Tërheqja	DIR	Bordi Menaxherial	KI	
Kriteret e përzgjedhjes		DIR	Bordi Menaxherial	DI
Lista e shkurtër dhe kujdesi		DIR	Bordi Menaxherial	DI
Përzgjedhja dhe njoftimi		Bordi Menaxherial	KI	DI
Rritja Reduktimi	DIR	Bordi Menaxherial	KI	DF
Zgjedhja e ETF:				
Inicimi dhe Tërheqja	DIR	Bordi Menaxherial	KI	
Kriteret e përzgjedhjes		DIR	Bordi Menaxherial	DI
Lista e shkurtër dhe kujdesi		DIR	Bordi Menaxherial	DI
Përzgjedhja		Bordi Menaxherial	KI	DI
Rritja Reduktimi	DIR	Bordi Menaxherial	KI	DI
Obligacionet e Kosovës:				
Norma dhe shuma për ofertim	DI	DIR	Bordi Menaxherial	DI
Norma dhe shuma për shitje	DI	DIR	Bordi Menaxherial	DI
Zgjedhja e letrave me vlerë:				
Inicimi	DIR	Bordi Menaxherial	KI	
Kriteret e përzgjedhjes	DIR	Bordi Menaxherial	KI	DI
Lista e shkurtër dhe kujdesi	DIR	Bordi Menaxherial	KI	DI
Përzgjedhja		Bordi Menaxherial	KI	DI
Rritja Reduktimi Tërheqja	DIR	Bordi Menaxherial	KI	DI
Depozitat bankare:				
Kriteret e përzgjedhjes		DIR	Bordi Menaxherial	DI
Lista e shkurtër dhe kujdesi		DIR	Bordi Menaxherial	DI
Përzgjedhja dhe njoftimi		DIR	Bordi Menaxherial	DI
Njoftimi i KI				DI
Menaxhimi i keshit		DF	DFI	DF
Rebalancimi	DIR	Bordi Menaxherial	KI	DI DF
Transferimi i aseteve për shlyerje midis portfoliove		DF	DFI	DF
Kostot e investimit (rishikimi)	DF	Komisioni për Buxhet	Bordi Drejtues	DF

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

www.trusti.org